

KOLEGJI UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”
University College “Canadian Institute of Technology” (CIT)

Licensuar me VKM nr.781, datë 10.11.2011
Akredituar me Urdhër nr.06, datë 27.01.2023
Zyra e Administratorit/ Administrator Office

Politika e vëzhgimit me kamera

1. HYRJE

Në këtë politikë përshkruhet mënyra e mbikëqyrjes me kamera vëzhgimi CCTV në të gjitha ambientet që ushtrohet veprimtaria e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”(në vijim KU “IKT”) në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale.

Gjithashtu edhe masat teknike e organizative që do të aplikohen për të siguruar besueshmërinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale përmes kryerjes së përpunimit të të dhënave nëpërmjet kamerave të vëzhgimit, periudha e ruajtjes së video regjistrimeve, mënyra e fshirjes, dhe të drejtat e detyrimet e personave të autorizuar që kanë akses në sistemin e vëzhgimit me kamera.

2. BAZA LIGJORE:

Kjo politikë është hartuar në bazë të:

- a. Ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”
- b. Ligji nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- c. Udhëzimit të Komisionerit nr.3, datë 30.04.2025 “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e videosurvejimit”
- d. Rregullore “Për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale”

3. QËLLIMI I PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE NËPËRMJET KAMERAVE TË VËZHGIMIT

Në zbatim të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” si dhe në mbështetje të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, KU IKT monitoron nëpërmjet kamerave të vëzhgimit ambientet e saj.

Vendosja e kamerave kryhet në mënyrë të tillë që të plotësojë qëllimin e politikave të KU IKT, për sigurimin e studentëve, stafit, pronës e materialeve të kolegjit nga një rrezik evident, si vjedhja apo kërcënim i sigurisë fizike ose mendore e personave që qëndrojnë brenda zonës së mbikëqyrur.

4. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE NEPERMJET KAMERAVE TE VEZHGIMIT

KU IKT garanton sistem të lartë sigurie për ruajtjen dhe përpunimin e mëtejshëm të të dhënave që përpunohen nëpërmjet vëzhgimit me kamera, në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Udhëzimi i Komisionerit nr.3, datë 30.04.2025 "Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e videosurvejimit".

Asnjë informacion që përpunohet nga sistemet e vëzhgimit me kamera nuk komunikohet ose shpërndahet përveç rasteve kur informacioni kërkohet nga organet kompetente që e fitojnë këtë të drejtë me ligj të veçantë duke respektuar kërkesat e ligjit.

Personat e autorizuar në KU IKT për përpunimin dhe administrimin e të dhënave nëpërmjet sistemeve të kamerave të vëzhgimit vënë në dispozicion materialet vizive apo të dhënat e tjera, që përfitohen nga përdorimi i masave shtesë të sigurisë, me kërkesë të Policisë së Shtetit ose organeve të drejtësisë, vetëm për nevojat hetimi, bazuar në Kodin e Procedurës Penale dhe në legjislacionin në fuqi.

Punonjësit e KU IKT i nënshtrohen detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit. KU IKT vlerëson integritetin e punonjësve të saj përpara se ata të punësohen.

KU IKT monitoron pajtueshmërinë e punonjësve të saj mbi detyrimet e tyre në lidhje me sigurinë e informacionit që përpunojnë.

5. KATEGORITË E SUBJEKTEVE TË TË DHËNAVE QË PËRPUNOHEN DHE RREGULLAT BAZE

Kamerat e vëzhgimit përpunojnë të dhënat e kategorive të ndryshme të subjekteve të të dhënave personale brenda kolegjit përfshirë por pa u kufizuar si në vijim, (studentë/punëmarrës/furnitorë/vizitorë etj).

Disa rregulla mbi vendosjen e kamerave në ambintet e KU IKT:

- a) Sistemi i kamerave nuk duhet të cenohet të drejtat themelore të individit duke ndërhyrë në jetën private të tij;
- b) Masat e sigurisë duhet të jenë të plota për mbrojtjen e të dhënave që përfitohen nga regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e këtyre të dhënave. Masat e sigurisë në KU IKT mbrojnë sistemet e regjistrimit dhe pajisjet e transmetimit që ruajnë të dhënat e regjistruara nga aksesit, ndryshimi, shkatërrimi, humbja apo përpunimi i paautorizuar ose aksidental;
- c) Masat e sigurisë nuk lidhen vetëm me masat e sigurisë fizike por KU IKT ka organizuar punën në mënyrë të tillë që i lejon personelit të ketë akses në të dhëna personale vetëm për aq sa është e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së tyre të punës.
- d) Në hyrje të ambienteve të kolegjit, të cilat monitorohen me kamera vëzhgimi, vendosen tabela informuese për njoftimin e subjekteve të të dhënave mbi ekzistencën e një sistemi vrojtimi;
- e) Kamerat nuk vendosen në hapësira të tilla si: tualete, dhoma zhveshje, dollapë apo ambiente të tjera të ngjashme;
- f) Ndalohet mbikëqyrja dhe transmetimi në kohë reale e imazheve të regjistruara nga sistemi CCTV,

nëpërmjet internetit ose shërbimeve të komunikimit elektronik, ku personat mund të identifikohen lehtë;

- g) Në ambientet e punës së personelit mund të vendosen kamera vetëm për të vëzhguar për arsye sigurie.

6. PËRDORIMI I SISTEMIT TË VËZHGIMIT ME KAMERA

- a) Pamjet e përftuara nga sistemi i kamerave dhe informacioni i regjistruar, kontrollohen vetëm nga Administratori i Kolegjit dhe një përfaqësues i departamentit të IT i autorizuar nga administratori .
- b) Në rastet kur kërkohet akses në të dhëna personale nga regjistrimi me kamera sa herë ka ankesa nga studentët apo stafi për humbjen e sendeve personale, ose për ndonjë arsye tjetër të përligjur, bëhet kërkesë me shkrim nga subjekti i të dhënave, në të cilën paraqitet arsyeja dhe koha kur ka ndodhur ngjarja. Kjo kërkesë administrohet nga drejtuesi i IT-së, pas miratimit nga Administratori i Kolegjit, duke garantuar kështu të drejtën për akses dhe të drejtën e përpunimit të të dhënave nga KU IKT. Në rast se dhënia e aksesit do të përmbushet duke i treguar subjektit të të dhënave materialin e regjistruar, KU IKT merr parasysh interesat e mbrojtjes së të dhënave të palëve të treta, duke bërë të mundur anonimizimin e videos duke errësuar imazhin e tyre.
- c) Nëse një subjekt i të dhënave kërkon akses në të dhënat e tij të videosurvejimit, këto të dhëna nuk mund të fshihen nga KU IKT pas marrjes së kësaj kërkesë.
- d) Personeli i autorizuar që ka dijeni për të dhënat e kontrolluara apo përpunuara, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.
- e) Drejtuesi i IT, ka detyrimin të njoftojë Zyrën e Komisionerit brenda 72 orëve në rast kompromentimi, manipulimi ose modifikimi të paautorizuar të sistemit.

7. ZONAT QË MBULOHEN NGA SISTEMI I VEZHGIMIT ME KAMERA

Në objektet e ushtrimit të veprimtarisë së KU IKT monitorohen me kamera vëzhgimi në mënyrë të pandërprerë:

- a. Hyrja kryesore në pjesën e jashtme të saj.
- b. Hyrja kryesore në pjesën e brendshme të saj, reception.
- c. Korridoret e brendshme të godinës që monitorojne zyrat dhe ambientet e punës.
- d. Ambientet e laboratorëve që monitorojne asetet e tyre.
- e. Korridoret e hapura, shkallët, ndërmjet të cilës aksesohet kati i dytë i godinës.
- f. Ambientet e jashtme të laboratorëve, që mundëson dhe akses në ambientin ku është vendosur gjeneratori.

Në ambjentet e KU IKT janë vendosur tabelat informuese sipas modelit zyrtar të miratuar nga Komisioneri në mënyrë që të garantohet informimi i individëve për sistemin e monitorimit me kamera në institucionin tonë.

8. AFATET E RUAJTJES TË TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të subjekteve përpunohen në sistemet e vëzhgimit me kamera CCTV në përputhje të plotë me masat e sigurisë të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Udhëzimit të Komisionerit nr.3, datë 30.04.2025 "Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e videosurvejimit .

Informacioni që regjistrohet është sekret. Ky informacion ruhet për një afat 15-30 ditë.

KU IKT mbron të dhënat në ambiente dhe sisteme të sigurta deri në përfundimin e afatit të përcaktuar, më pas të dhënat fshihen automatikisht nga sistemi i vëzhgimit.

9. AKSESI NË TË DHËNAT PERSONALE

KU IKT përpunon të jetë sa më e hapur për t'i dhënë individëve akses në të dhënat e tyre personale. Subjektet e të dhënave personale mund të informohen nëse ne mbajmë të dhëna personale të përfituar nga sistemet e vëzhgimit me kamera, duke na dërguar një "kërkesë" sipas modelit bashkëlidhur kësaj politike, dhe në bazë të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale, KU IKT ju informon brenda afatit ligjor mbi të dhënat ose ju shpjegojmë arsyen e mosdhënies së informacionit.

10. TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Individët, të dhënat personale të cilëve përpunohen, kanë të drejtë në bazë të ligjit nr.124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të verifikojnë për ekzistencën ose jo të të dhënave personale dhe të dinë përmbajtjen dhe burimin e tyre, të verifikojnë saktësinë, përditësimin ose korrigjimin, të kërkojnë informacion për qëllimin e përpunimit , për kategoritë e të dhënave personale të përpunuara, si dhe në çdo rast të kundërshtojnë, për arsye të ligjshme, trajtimin e tyre. KU IKT ju informon për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, si edhe mbi çdo të drejtë që në cilësinë e subjektit të të dhënave gëzon në përputhje me ligjin nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

11. KONTAKT

Kërkesat për informacion në lidhje me politikën tone të vëzhgimit me kamera mund të dërgohen me e-mail në adresën info@cit.edu.al.

12. DISPOZITA TE FUNDIT

Në rast keqpërdorimi apo cënimit të privatësisë nëpërmjet sistemeve të vëzhgimit me kamera, subjektet e të dhënave kanë të drejtë të ankohen pranë:



Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në adresat e mëposhtme:

Nr. Gjelbër 0800 20 50 / www.idp.al / info@idp.al

Nr. _____ Prot

Datë _____

KËRKESE

Lënda: Për vënien në dispozicion të pamjeve filmike në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë’

Drejtuar: Administratorit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë’

Unë i/e nenshkruari/a _____, lindur më datë ____/____ /_____
banues në _____, kërkoj të më vihen ne dispozicion kopje te pamjeve të Video Survejimit të
KU IKT më datë _____, gjatë periudhës kohore nga _____ në _____, në
vendin _____, për arsyet e mëposhtme:

KËRKUES

Bashkëlidhur kopje të kartës së identitetit.